

KONTRATE SHIT-BLERJE
Kuotave te shoqërisë "SHEHAB&RIHAN -PARTNERS"
Baza Ligjore
Nenet 6, 705-750 te Kodit Civil

Në Tiranë, sot më 03/04/2021 (dymijë e njezetenje), palet:

SHITESI: **Z. Nikolle Ndoci**, i datëlindjes 01.08.1967, lindur në Gjadër, Lezhë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr. personal **G70801069S**

BLERESIT:

- **Zoti Shehab Ahmad Ali Abumayha**, shtetas Jordanez, lindur ne Kuvajt, me14.09.1973, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës e pasaportës me nr. Q089428.
- **Zoti Ramadan Abdulhameed M.Rihan**, shtetas Jordanez, lindur ne Amman, me 05.09.1975, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës e pasaportës me nr. P198622.

Palët, me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe ne mirëkuptim te ndërsjelle, nenshkruajn kete kontrate, ne kushtet dhe me te dhënat e mëposhtme:

TE DHENA PARAPRAKE

- I. Shitësi është ortak i 10% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë Kufizuar "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" me NIPT M01412506D, themeluar dhe regjistruar me date 04/01/2019 me seli ne adresën: Durres, RRASHBULL Njesia Administrative Rrashbull, banesa me nr.pasurie 94/175, zona kadastrale 3215, kati 1.
- II. Shoqëria "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" me vendimin nr 4, date 03.04.2021, te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve kane dhëne pëlqimin për shitjen 10 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" nga totali i kuotave prej 10% te ortakut **Z. Nikolle Ndoci**, ne cilësinë e shitësit, tek blerësit, perkatesisht ortakët e shoqërisë, **Zoti Shehab Ahmad Ali Abumayha – 5 %** dhe ortakut, **Z. Ramadan Abdulhameed M.Rihan – 5%**.
- III. Mbi kuotat e kapitalit themeltar te shoqërisë "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" nuk ka asnjë barre siguroese.

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë se luajtshme sipas kuotave te përcaktuara me poshtë, te kapitalit themeltar te shoqërisë "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" nga shitësi ne favor te palëve blerëse.

- **Z. Nikolle Ndoci**, shet 10% nga pjesa e vet prej 10% te kuotave me vlere nominale 10 000 (dhjete mije) lek.

NENI 2

Çmimi

2.1 Shitësi ia shet këtë pasuri blerësve kundrejt një çmimi dhe përkatësisht sipas ndarjes:

- a) **Z. Nikolle Ndoci**, shet 5% nga pjesa e vet takuese prej 10% te kuotave te shoqërisë "**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**" me vlere nominale 5 000 (pese mije) lek, te cilat i blen **Z.Ramadan Abdulhameed M.Rihan**.

- b) **Z. Nikolle Ndoci**, shet 5% nga pjesa e vet takuese prej 10% te kuotave te shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” me vlere nominale 5 000 (pese mije) lek, te cilat i blen **Z. Shehab Ahmad Ali Abumayha**.

2.2. Palët deklarojnë se çmimi është paguar nga blerësi ne favor te shitësve, te cilët nuk kane asnjë pretendim.

2.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje kuotash dhe regjistrimin e saj ne QKB, **Z. Nikolle Ndoci** largohet si ortak i Shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” ndërsa zoti **Z. Shehab Ahmad Ali Abumayha** behet ortak i shoqërisë me 50% te kuotave te shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” me një vlere nominale prej 50 000 (pesëdhjete mije) lek, si dhe **Z. Ramadan Abdulhameed M. Rihan** behet ortak i shoqërisë me 50% te kuotave te shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” me një vlere nominale prej 50 000 (pesëdhjete mije) lek.

NENI 3

Te drejtat dhe detyrimi i palëve

3.1 Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë te pasurisë objekt kontrate dhe saktësinë e dokumentacionit zyrtar te saj, ne te kundërt mban përgjegjësi civile për demin e shkaktuar.

3.2 Shitësi është i detyruar ti dorëzoje pasurinë objekt kontrate me gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ky i fundit.

3.3 Shitësi është i detyruar ti dorëzoje pasurinë objekt kontrate blerësit te shkarkuar nga çdo e drejte apo pretendim i te tretëve.

3.4 Blerësi ka detyrim te njoftoje brenda 5 ditëve shitësin ne rast se te trete ngrëne pretendime pronësie mbi sendin objekt kontrate.

NENI 4

Kalimi i pronësisë

Me nënshkrimin e kontratës, shitësi **Nikolle Ndoci** zhvishet plotësisht nga pronësia mbi 10% (dhjete për qind) te kuotave si me sipër dhe ajo i kalon e plote blerësve. Blerësit:

- Zoti **Ramadan Abdulhameed M. Rihan**, behet zotërues i 5% (pese për qind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” te perfituara nga shitesi Nikolle Ndoci, duke u bere keshtu ortak me 50% te kuotave te shoqërisë, si dhe
- Zoti **Shehab Ahmed Ali Abumayha**, behet zotërues i 5% (pese për qind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë “**SHEHAB&RIHAN -PARTNERS**” te perfituara nga shitesi Nikolle Ndoci, duke u bere keshtu ortak me 50% te kuotave te shoqërisë.

NENI 4

Te ndryshme

5.1 Palët u porositen qe te depozitojnë këtë kontrate ne Qendrën Kombëtarë te Biznesit.

5.2 Palët do te përpiqen te zgjidhin me mirëkuptim te gjitha mosmarrëveshjet qe mund te lindin për shkak te ekzekutimit te kësaj kontrate. Ne rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre ehte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kontrata iu lexohet të paleve te cilët e kuptojnë, pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin.

Kontrata redaktohet ne 4 kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlere te njëjtë juridike.

SHITESI

Nikolle Ndoci

BLERESI

Ramadan Abdulhameed M. Rihan

Shehab Ahmed Ali Abumayha

